

**Komuna e Shtimës
DREJTORIA E PROKURIMIT**

**KONTRATA PUBLIKE KORNIZË 24 MUAJ
617-26-1869-2-1-1/C939**

Komuna Shtime Rr.,Tahir Sinani, nr 50,tel. 0290-389-016-228 të cilën e përfaqëson, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit Muhadin Halili në njërën anë ,
dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik TALA ENGINEERING SH.P.K.; EURO RAKETA SH.P.K., Rr.Mitrovica, Prishtine ,që e përfaqëson Taulant Bajrami i autorizuari tel. 044-604-537 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për shërbimet e mirëmbajtjes si në vijim:

Mirëmbajtja e ndriçimit publik (kontratë kornizë dy vjeçare)

Me numër identifikues: 617-26-1869-2-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes në vijim:

Mirëmbajtja e ndriçimit publik (kontratë kornizë dy vjeçare)

Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Kontraktori, duke specifikuar listën e shërbimeve (punëve) që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të e vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti Kontraktues i përmendur në Nenin1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbime (punë), të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 21.05.2026 dhe përfundon me 21.05.2028

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e shërbimeve do të jetë **1 (një) ditë** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i ekzekutimit të shërbimeve(Mirëmbajtjes),do të jetë:**Komuna e Shtimes me të gjitha vendbanimet.**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve (punëve) riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga kontraktuesi është 352.85 € (tre/pesë/dy/tetë/pesë) çmimi për njësi. **Vlera e parashikuar e kontratës për 24 muaj është 170,000.00 euro, (një/shtatë/zero/zero/zero/zero/zero)**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisve do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *Plani Dinamik*
- (h) *Sigurimi i ekzekutimit*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	20.05.2026
Vula:	

Në rast të kontratave me vlerë të madhe

Emri:	Qemajl Aliu
Pozita:	Kryetar i Komunes
Nënshkrimi:	
Data:	21.05.2020
Vula:	

Për Kontraktorin

Emri:	Taulant Bajrami
Pozita:	I autorizuari
Nënshkrimi:	
Data:	20.05.2026
Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 617-26-1869-2-1-1/C939

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cilin është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguroesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguroesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e

Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në

mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paafësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasë ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbimë parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;

- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike komizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike komizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë asemi të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

617-26-1869-2-1-1/C939


KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Nr. Nenit</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve (mirëmbajtjesë) është 21.05.2026
	6.4	Data e Përfundimit është :21.05.2028
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjesë është:Komuna e Shtimes me të gjitha vendbanimet
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i projektit emrohet nga ZKA
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25 % e çmimit për njësi në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10 % të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është: 10 % e vlerës së kontratës për një periudhë për 25 muaj nga nënshkrimi i kontratës .
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë OE b) Përgjegjësia e Palës së Tretë OE c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve OE d) Përgjegjësia profesionale Bie mbi OE e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës Bie mbi OE
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: OE,duhet të sjellë faturen e rregullt.Në faturë duhet të figurojë: Emri i projektit ,nr,i kontratës si dhe nr. i urdhërblerjes ,fatura duhet të jetë e protokoluar , raporti i menaxherit të kontratës për shërbimet e kryera , pastaj bëhet pagesa .
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga autoriteti kontraktues do të jene në vijim: Menaxheri i projektit do të kontrollojë çdo detal të projekteve .
Zgjidhja miqësore e	20.2	Për çdo mosëmarrveshje eventuale në mes AK dhe OE do të zgjidhen


mosmarrëveshjes		<i>me marrëveshje</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>gjykatën kompetente</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.

Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik në qytet dhe fshatra -kontratë kornizë 24 muaj					
	Pershkrimi i qmiveve (Pjesa e parë)	N.J.M	Sasia	ÇMIMI me TVSH	Totali me TVSH
1	Furnizim dhe montimi Poç eficient - 40W, Tension pune 90-240/50-60Hz	Copë	1	1.00	0.85
2	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese LED 50W me llupë.Llampa nga aspekti i dizajnit duhet të plotësojë standardet Europiane, EN 60598-2-3,EN 55015 DHE TË KETË; Mbrojtjeje : IP65(IP66).Qëndrueshmëri pune ≥50000 Efkasitet ndriçueshmërisë së IT ≥125LM/ë Në 50000 (h/punë) të LEDIT- L70/B20 Temperaturë të ngjyrës:≤5000K Tension pune :90...270V (50Hz) Faktor të Fuqisë:≥0.92 Temperaturë pune:(-40...+60)°C Mbrojtjeje nga goditja:IK10,	Copë	1	68.00	57.80
3	Furnizimi me trafo për trup LED 50W dhe montim	Copë	1	1.00	0.85
4	Furnizim me trafo për trup LED 100W dhe montim	Copë	1	1.00	0.85
5	Furnizim dhe montim i lirave 0,70cm me këndin 15°.	copë	1	45.00	38.25
6	Furnizim dhe montim i lirave 1.20cm me këndin 15°.	copë	1	45.00	38.25
7	Furnizimi i CN kontaktorit 16 A dhe montimi	Copë	1	5.00	4.25
8	Furnizimi i CN kontaktorit 63A dhe montimi	Copë	1	5.00	4.25
9	Furnizim me AES trepolar, ndërprerës mbrojtës nga lidhja e shkurtë dhe mbingarkesa 63 A, .	copë	1	2.00	1.70
10	Furnizim dhe montim me AES trepolar, ndërprerës mbrojtës nga lidhja e shkurtë dhe mbingarkesa 80 A.	copë	1	2.00	1.70
11	Furnizim dhe montim me AES trepolar, ndërprerës mbrojtës nga lidhja e shkurtë dhe mbingarkesa 160 A.	copë	1	2.00	1.70
12	Furnizim dhe montim me AES katërpolar, ndërprerës mbrojtës nga lidhja e shkurtë dhe mbingarkesa 63 A, .	copë	1	2.00	1.70
13	Furnizim dhe montim me AES katërpolar, ndërprerës mbrojtës nga lidhja e shkurtë dhe mbingarkesa 80A, .	copë	1	2.00	1.70
14	Furnizim dhe montim me AES katërpolar, ndërprerës mbrojtës nga lidhja e shkurtë dhe mbingarkesa 160 A.	copë	1	3.00	2.55
15	Furnizimi i siguresave TZ 63-25A komplet dhe montimi	Copë	1	2.00	1.70
16	Furnizimi i siguresave automatike 6-10-16-20-25 ,32,63A dhe montimi	Copë	1	3.00	2.55
17	Furnizimi i kabllos PVC- Cu- 3x2.5mm ² dhe montimi në trupin ndriçues.	m'	1	5.00	4.25
18	Furnizimi i kabllos NAYY-AL-4x35mm ² nëntokësore si dhe montimi i saj nga trafostacioni deri te ormani shpërndarësë	m'	1	2.00	1.70
19	Furnizimi dhe vendosja e kabllos për furnizimin e trupave ndriçuese NAYY (Al) 4x16mm ² prej KKS-SË, nëntokësore.	m'	1	20.00	17.00
20	Furnizimi i kabllos PPOO-AL-2x16mm ² ,kabël bistek ajrore si dhe montimi i saj (prej shtyllë ne shtyllë)	m'	1	8.50	7.23


Pjesa e parë qmimi i peshuar 85%



21	Furnizimi i kabllos PPOO-AL-4x16mm ² , kabëll bistek ajrore dhe montimi i saj (prej shtyllë në shtyllë)	m'	1	8.50	7.23
				233.00	198.05
	Pershkrimi i qumëve (Pjesa II)	N.J.M	SASTA	CMIMI me TVSH	Totali me TVSH
1	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese LED 100W me llupë. Lampa nga aspekti i dizajnit duhet të plotësojë standardet Europiane, EN 60598-2-3, EN 55015 DHE TË KETË; Mbrojtjeje : IP65(IP66), Qëndrueshmëri pune ≥50000 Efikasitet ndriçueshmërisë së IT ≥125LM/e Në 50000 (h/punë) të LEDIT- L70/B20 Temperaturë të ngjyrës: ≤5000K Tension pune :90... 270V (50Hz) Faktor të Fuqisë: ≥0,92 Temperaturë pune: (-40... +60)°C Mbrojtjeje nga goditja: IK10,	Copë	1	66	9.90
2	Furnizimi i kapakëve për shyllat ndriçues me pjesë reduktuese me gjatësi H-9m, me bulona adekuat dhe montimi i tyre.	Copë	1	2.00	0.30
3	Furnizimi i kapakëve për shyllat ndriçues me pjesë reduktuese gjatësi H-5 m ,me bulona adekuat dhe montimi i tyre.	Copë	1	2.00	0.30
4	Furnizimi i kapakëve për shyllat ndriçues konike me gjatësi H=8,8,7,8,6,8,5,5 m ,me bulona adekuat dhe montimi i tyre.	copë	1	2.00	0.30
5	Drejtimi i shtyllave ndriçues H-9 m,5m me pjesë reduktuese	Copë	1	50.00	7.50
6	Drejtimi i shyllave konike ndriçues me gjatësi 8,8m,7,8m,6,8m,5,5m.	Copë	1	50.00	7.50
7	Drejtimi i lirës së shtyllave ndriçues me pjesë reduktuese me gjatësi H -9m ,5m dhe montimi	copë	1	50.00	7.50
8	Drejtimi i lirës së shtyllave ndriçues konike me gjatësi H - 8,8m,7,8m,6,8m, 5,5m dhe montimi	Copë	1	50.00	7.50
9	Furnizimi i kabllos PPOO-Y-5x16mm ² si dhe montimi i saj (kablo prej bakri) nëntokësore	M'	1	1.00	0.15
10	Furnizimi i kabllos PPOO Y5x10mm ² si dhe montimi (kabllo prej bakri) nëntokësore	M'	1	1.00	0.15
11	Furnizimi i ndërprerësit 250A 1-0-2 dhe montimi	Copë	1	2.00	0.30
12	Furnizimi i ndërprerësit 160A 1-0-2 dhe montimi	Copë	1	3.00	0.45
13	Furnizimi i ndërprerësit 100A 1-0-2 dhe montimi	Copë	1	3.00	0.45
14	Furnizimi i ndërprerësit 63A 1-0. 2dhe montimi	Copë	1	2.00	0.30
15	Furnizimi i ndërprerësit 16A 1-0-2 dhe montimi.	Copë	1	3.00	0.45
16	Furnizimi i siguresave thikore 250A dhe montimi	Copë	1	2.00	0.30
17	Furnizimi i siguresave thikore 160A dhe montimi	Copë	1	3.00	0.45
18	Furnizimi i siguresave thikore 100A dhe montimi	Copë	1	2.00	0.30
19	Furnizimi i siguresave thikore 80A dhe montimi	Copë	1	2.00	0.30
20	Intervenim në shtyllen rënuar ,aksidentuar dhe largimi nga rruga ,bartja ,deri në depo sipas urdhrat të organit mbikqyres , policisë	Copë	1	120.00	18.00




21	Intervenim-saldimi i shtyllës ndriçus nese ka ardhë deri te ndonjë aksident komunikacioni ne trup ndriçues –aftësimi, dhe funksionalizimi i saj ose edhe furnizim dhe montim me shtyllë të re ,shtyllave me pjesë redukuese me gjatësi 9m ,5m e punuar sipas standardit ISO UN EN ISO 1461 standard i zingimit e galvanizuar, shtylla të realizuara me hankerim.	Copë	1	150.00	22.50
22	Intervenim-saldimi i shtyllës ndriçus nese ka ardhë deri te ndonjë aksident komunikacioni ne trup ndriçues –aftësimi, dhe funksionalizimi i saj ose edhe furnizim dhe montim me shtyllë të re ,shtyllave /konike punuar sipas standardit ISO UN EN ISO 1461 standard i zingimit e galvanizuar dhe pjekja e ngjyrës në fur (kodi RAL 9011) sipas standardit ISO 12944-5. Shtylla te realizuara me mbjellje.. me gjatësi 8.8m,7.8m,6.8m,5.5m .	copë	1	130.00	19.50
23	Furnizimi i fundoreve për kablllo ajrore të nriqimit publik myarësisht të seksionit të kablllos në terren si dhe montimi i tyre	Copë	1	15.00	2.25
24	furnizimi dhe montimi i halkkave, unazave me material të qelikutë e zinguar,për përforcimin e kablllos në shtylla të drurit ,betonit.	copë	1	1.00	0.15
25	furnizimi dhe montimi i klemave për lidhje të kablllove ajrore furnizuese të nriqimit publik myarësisht të seksionit të kablllos në terren.	copë	1	1.00	0.15
26	Furnizimi i lidheseve –mufave për vazhdimin e kablllove nëntokësore si dhe montimi i tyre 10,16,25,35,50 mm.....	Copë	1	1.00	0.15
27	Gjetja e kabllave të dëmtuara në tokë gjatë punimeve të kanalizimeve dhe gjatë goditjeve të trupave me vetura të ndryshme ku kanë dëmtuar kabllot në tokë. Tereni ku duhet të intervenohet ka asfalt, kubëza betoni, kallderm , dëmtimet në tokë nuk dihen sa sa janë pa u gjetë me u gërmua , (shplua) etj. Pas intervenimit gjithqka duhet te kthehet ne gjendjen si ka qene.	Vende	1	5.00	0.75
28	Gjetja dektektimi i kablllos së dëmtuar ajrore për gjatë rrjetit ajrore të ndriqimit publik.	vende	1	100.00	15.00
29	Ngjyrosja e shtyllave metalike ,shtyllave konike të punuar sipas standardit ISO UN EN ISO 1461 standard i zingimit e galvanizuar dhe pjekja e ngjyrës në fur (kodi RAL 9011) sipas standardit ISO 12944-5. duke përfshirë edhe lirat anësore. Shtylla te realizuara me mbjellje.. me gjatësi 9.0m 8.8m,7.8m,6.8m,5.5m .komplet me lira. .	Copë	1	5.00	0.75
30	Ngjyrosja e shtyllave metalike me gjatësi –H9.m, 5m me pjesë redukuese duke përfshirë edhe lirat anësore me ngjyrë speciale-STO CO 6RR Finish RAL DB 702 ose e ngjajshme, metalike hiri ose bronzi.Komplet.	Copë	1	5.00	0.75
31	Gjetja e kablllos të dëmtuar nëntokësore me Meger,	Ora	1	1.00	0.15




32	Prerja e asfaltit për afësimin e kablove të dëmtuara dhe kthimi i gjendjes mëparëshe pas vendosjes të kabllës me gjersia e asfaltit 50 cm \approx 7cm, duke stabilizuar fillimisht nën bazën me zhavor. Furnizimi ,bartja ,shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi $t=20$ cm, furnizimi ,bartja ,shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31,5 mm	m ²	1	1.00	0.15
33	Demolimi i trotuarit egzistues dhe kthimi në gjendjen e mëparëshe komplet me ngjeshje, zhavorin për vendosjen e kabllës furnizuese të dëmtuara	m ²	1	1.00	0.15
34	Hapja e vrimës për bazament të shtyllës gjatë dëmtimit në rastë aksidenti, vendosja e gypit Ø 250PE, 200 PE depërtimi i gypit Ø70,60 në gypin Ø 250,200 punët tjera dhe betonimi i bazamentit të shtyllave në cilindrin Beton armë, Ø600/1000, Ø800/1000 (në vendet ku është thellësia e madhe e kanalit varishtë nga pozita e terrënit Ø600/1000, Ø600/500), Ø800/1000, Ø800/500 (Llogaria e sasisë së betonit në qmim përfsinë sasinë e vëllimit të cilindrit me lartësi h=0.5m , h=1 m dhe diameter d=0.25m që mbushet me rërë që i zbritet cilindrit të parë) për shtylla me beton të tipit C=30/37, rezistuse ndaj teperaturave të ulëta dhe kripës	Copë	1	5.00	0.75
35	Mitja e kanalit për shtrirjen e kabllës tokësore me dimenzione 75x50cm si dhe mbulimi pas vendosjes të kabllës në kanal të bëhet ngjeshja me makinë përkatëse.	m ¹	1	10.00	1.50
36	Në rast të paraqitjes së defekteve nën rrugë nevojitet Shpimi-Depertimi nën rrugën e asfaltuar dhe trotuarit për vendosje të kabllëve pa dëmtim të trotuarit dhe rruges gjatësia e shpimit min 50 m, ky pozicion duhet të realizohet me makine adekuate diametri që duhet të bëhet shpimi max Ø100mm.	m ¹	1	5.00	0.75
37	Furnizimi dhe montim transporti dhe shpërndarja e rërës së imtë në kanal in e rrjetit të ndriçimit publik për mbrojtjen e tubit brinjor dhe kabllës të deportuar në teme dimenzione 0,2x0,5xm	m ³	1	5.00	0.75
38	Furnizimi dhe montim shtrirja e shiritit të zinkuar FeZn (3x25)mm për krijimin e rrjetës së përtokëzimit për çdo shtyllë duke parapar pllakat kryqëzuese 60x60x3mm dhe realizimi i përtokëzimit përmes mbërthimit në dadon ekzistuese të shtyllës apo kornizës metalike, si dhe ljerja me ngjyrë antikorzion në vendet e salduara të shiritit dhe bufonave shtërngues	m ¹	1	10.00	1.50
39	Furnizimi dhe montim i sondës për tokëzimin e trupit ndriçues nëse nuk ka shirit në kanal apo s'ka kushte teknike për tokëzimin e trupit ndriçues.Fc/Zn Ø75/2000mm	copë	1	5.00	0.75
40	Furnizimi dhe montimi i ankerit ,dados (shtrafave) dhe vendosja në bazament për trupin ndriçues.	copë	1	1.00	0.15
41	Furnizimi dhe montim dhe betonimi me beton të tipi MB25 në gropat e hapura për shtylla ndriçuese me dim 0.8x0.8x1m, për vendosjen e shtyllave të ndriçimit publik.	copë	1	1.00	0.15

Pjesa e Dytë qmimi i peshuar 15%





42	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese LED 150W me llupë. Lampa nga aspekti i dizajnit duhet të plotësojë standardet Europiane, EN 60598-2-3, EN 55015 DHE TË KETË; Mbrojtje : IP65(IP66). Qëndrueshmëri pune ≥ 50000 Efikasitet ndriçueshmërisë së IT $\geq 125LM/\bar{e}$ Në 50000 (h/punë) të LEDIT- L70/B20 Temperaturë të ngjyrës: $\leq 5000K$ Tension pune :90....270V (50Hz) Faktor të Fuqisë ≥ 0.92 Temperaturë pune: (-40...+60)°C Mbrojtje nga goditja: IK10 Garancion ≥ 5 vite	Copë	1	69.00	10.35
43	Furnizimi dhe vendosja e tubit të brinjëzuar PVC $\phi 50$ mm për kablion furnizuese të trupave ndriçues.	M'	1	5.00	0.75
44	Furnizimi i pllakës-izoluse për lidhjen e kabllove-vazhdimi në trupin tjetër dhe montimi i saj me katër lidhje.	Copë	1	1.00	0.15
45	Furnizimi i pllakës-izoluse për lidhjen kabllove – vazhdimi në trupin tjetër dhe montimi i saj me tri lidhje	Copë	1	1.00	0.15
46	Furnizimi me reduktor -E-27/E-40 dhe montimi	Copë	1	1.00	0.15
47	Furnizimi i ormanit rrugor për ndriçim publik 1.20x0.90x0.30 m me kulm ,mbrojtje IP54 , me çels trekëndësh univërzal, dhe montimi .	Copë	1	10.00	1.50
48	Ndërtimi i bazamentit të betonit për KSSH të ndriçimit me dimenzione 1.20x90x30cm komplet	Copë	1	2.00	0.30
49	Furnizimi i bazave të siguresave 250/500A dhe montimi	Copë	1	1.00	0.15
50	Furnizimi i bazave të siguresave të shkurta 63-160A dhe montimi	Copë	1	1.00	0.15
51	Ngjyrosja e ormanëve të ndriçimit publik me ngjyrë antikoroëdive në lokacionet ku paraqitet nevoja.	Copë	1	1.00	0.15
52	Furnizimi dhe montimi i drynit trekëndësh univërzal për mbylljen e ormanëve	Copë	1	1.00	0.15
53	Intervenim –saldimi i kandillabres të këputur në trupin ndriçues.	Copë	1	1.00	0.15
54	Furnizim dhe montim i dyerve të ormanëve të ndriçimit publik. Vlen vetëm për dyer të ormanëve të dëmtuar	Copë	1	1.00	0.15
55	Furnizimi dhe montimi i reflektorëve led 100 W	copë	1	20.00	3.00
56	Furnizim dhe montim i reflektorëve led 150 W	copë	1	20.00	3.00
57	Furnizim dhe montim i gypit PVC $\phi 200,250$ me gjatësi 1m dhe 0,5m të cilat përdoren gjatë montimit të shtyllave të aksidentuara .	copë	1	10.00	1.50
58	Gërmimi i kanalit në vende rurale për shtrirjen e kabllos tokësore me dimenzione 75x50cm si dhe mbulimi pas vendosjes të kabllos në kanal të bëhet ngjeshja me makinë përkatëse	m'	1	10.00	1.50
59	Largimi i banerave, reklamave, kabllove e elementeve tjera të vendosura pa pëlqimin nga shtyllat e ndriçimit publik, me udhëresë të organit Mbykëqyësës.	Copë	1	2.00	



60	<p>Furnizimi dhe montimi i rele kohor TIME SWITCH ,digjital astrologjike (rele e cila bazohet me interval kohor) për aktivizimin automatik të ndriqimit publik.</p> <p>*Tensioni i furnizimit (230) V.</p> <p>*Releja duhet të ketë qartifikaten e prodhuesit me ISO standarde.</p> <p>SQARIM.*Rele astrologjike foto voltaice që mundëson kyqjen e qarkut me errësirë me anë të sensorit të foto qelisë dhe deaktivizimit të qarkut me orara tëcaktuar nëformë automatike varësisht nga kërkesat, *Releja duhet të jetë 24 orë dhe 7 ditë në javë në funksion të pandërprerë (me bateri) edhe në rastë të ndërprerjes së rrymës elektrike.</p> <p>*Releja duhet të jetë lehtë e menaxheshme. *Të ketë mundësi hapëse dhe mbyllëse të qarkut në mënyrë automatike dhe manuale me orar tëcaktuar dhe me sensor mvarësisht nga kërkesat .</p>	Copë	1	1.00	0.15
----	--	------	---	------	------

			1032	154.80
	Rikapitullim i Përgjithshëm	%	Çmimi total i pa peshuar	Çmimi total i peshuar
1	TOTALI I	85.00%	233.00 €	198.05 €
2	TOTALI 2	15.00%	1,032.00 €	154.80 €
	TOTALI			352.85 €
				352.85 €

Emri i Kompanisë	TALA ENGINEERING SHPK
Adresa e Plote	RR.MITROVICA NR 4 PRISHTINE
Përfaqësuar Nga:	
Emri & Mbiemri	TAULANT BAJRAMI
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi	
Data	30.04.2026
Vula	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office

Datë: 21/05/2026

Nr.prot: 02/ 588

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 54 të Statutit të Komunës së Shtimes, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"Mirëmbajtja e ndriçimit publik (kontratë kornizë dy vjeçare)"** si në vijim:
 - 1.1 Armend Imeri **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 Halil Kurtishi **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe manualin për përdorim të modulit për menaxhim të kontratës.
3. Të dërgohet raport i rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Prokurimit;
Z. Armend Imeri;
Arkivi





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **150152**

Për **KOMUNA SHTIME**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **TALA ENGINEERING SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Titulli: Mirëmbajtja e ndriçimit publik (kontratë kornizë dy vjeçare)**

Nr. prokurimit: 617-26-1869-2-1-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t`i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **17,000.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **17,000.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 765 ditë kalendarike prej **20.05.2026** deri më **23.06.2028**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 20.05.2026

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.